

LIGJ
Nr.7562, datë 30.4.1992

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7526, DATË. 3.12.1991 "PËR MARRËDHËNIET E PUNËS"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

Në ligjin nr.7526, datë 3.12.1991 "Për marrëdhëniet e punës", pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me kete permbajtje:

"Për nevoja të veçanta që lidhen me përmirësimin e funksioneve të strukturave të aparatit shtetëror, për vënien në jetë të reformës organi kompetent ka të drejtë të transferojë nëpunësin në një vend tjetër pune brenda profesionit të tij.

Kur gjetja e vendit tjetër të punës është objektivisht e pamundur e kalon atë në një punë tjetër ose në asistencë sociale".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.174, datë 4.5.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha